



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Fier, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** "Reabilitim i Kanalit Ujitës "Vjosë- Levan- Fier": Dega e Martinës, (faza 3),

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45247111-1 -  
Punime ndërtimi për kanale ujitëse**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** **51 797 141 . 60** (pesëdhjetë e një milion e shtatëqindë e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqindë e dyzet e një pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në

*vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

*përbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas percakttimeve te bera ne Shtojcen 9 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (*dy*) viteve të fundit (**2022, 2023**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues eshte ne kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te eksperit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japid informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.* Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisacionit të fushës, konkretisht ne ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

**2.2.2.** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2022, 2023**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se **50 000 000 leke pa TVSH** (*e cila është një vlerë që nuk tejkalon vlerën e përllogaritur të kontratës që prokurohet*). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriteri plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Ky kriteri është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 ”Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japid informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*; në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përbushur me sukses kontratën siç është

parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhan maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legiislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

---

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulan kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e 2 (dy) viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

#### **2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:**

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**ose**

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

## **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:**

i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përbushjen e suksesshme të punëve:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërise, etj.

ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Fatura tativore përfundimtare.

*Në rastin e paraqitjes së ofertave nga bashkimi i operatoreve, pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjera të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përbushë këtë kusht.*

*Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e

procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të janë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vleres limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor kërkon kontratë të ngjashme në vlerë 50 % të vlerës së fondit limit, pasi vlera e parashikuar e kontratës është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme si dhe referuar metodave të përforcimit të objekteve sipas projektit zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

### **2.3.2 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime.**

**a)** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierin e mëposhtëm:

- |           |                              |          |
|-----------|------------------------------|----------|
| <b>1.</b> | Inxhinier ndërtimi           | 1 (një); |
| <b>2.</b> | Inxhinier Hidroteknik        | 1 (një); |
| <b>3.</b> | Inxhinier topograf / gjeodet | 1 (një); |

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën **Maj 2024**. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, kontratë individuale punë (*e vlefshme*).

Stafi iinxhiniereve te licencuar bazohet në Vendimin nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimitari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar.

**b)** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar **1 (një) punonjës që të disponojë** çertifikatë / dëshmi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e nr.10 237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Për punonjesin e sipërcituar duhet të paraqitet dëshmi/çertifikatë ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tij, kontratë individuale e punës e vlefshme për të paktën

periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve si dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë per muajin Maj 2024.

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **specialistë te çertifikuar sipas profesioneve**, të paktën si më poshtë:

- |                             |   |
|-----------------------------|---|
| ➤ Teknik Ndertimi           | 1(një) (në listë pagesë)                        |
| ➤ Karpentier                | 1 (një),(në listë pagesë ose me kontratë pune)  |
| ➤ Eskavatorist              | 1 (nje), (në listë pagesë ose me kontratë pune) |
| ➤ Automakinist              | 3 (tre), (në listë pagesë ose me kontratë pune) |
| ➤ Shofer me leje drejtimi C | 2 (dy), (në listë pagesë ose me kontratë pune)  |

**Shënim:** Për pikat **a), b) dhe c)** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, në përfundim të fazës së dytë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit (për këtë fazë), duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përbledhës të vetëdeklarimit,sic kërkohet në shkronjat **a), b) dhe c)** të pikes **2.3.2**, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë :

- Për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten , dëshmitë / çertifikatat ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të paktën periudhen e parashikuar të zbatimit të punimeve.
- Për punonjësit për të cilët kërkohet listë pagesa duhen të jenë të përfshirë në listë pagesën e muajit **Maj 2024**

**Argumentimi:**Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkrektisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve dhe me mjetet e kërkuarë për zbatimin me sukses të kësaj kontrate si dhe në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, sipas portalit SIM në e-albania.

Emërtimi i manovratorve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për preqatitjen teorike- praktike të

kandidateve, si dhe dhenien e deshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë , si dhe disiplinimi i perdonimit te makinerive te ndertimit". Vendosja e këtij kriteri për Inxhinieret me licencë është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve dhe me mjetet e këruara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate si dhe në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimitari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" i *ndryshuar*.

Pikat e licencës së firmës/ave janë nxjerrë bazuar në VKM nr.42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimitari ndërtimi", i *ndryshuar* dhe preventivit të punimeve.

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet te ketë fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, një numer prej jo me pak se 82 punonjes per muajin Maj 2024 (pa perfshire ne kete numer specialistet e certifikuar : Karpentier 1 (një), Eskavatorist 1 (një), Automakinist 3 (tre), Shofer me leje drejtimi C 2 (dy),

**Shënim:** Për pikën **2.3.3** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, në përfundim të fazës së dytë, përpala publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit (për këtë fazë), duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përbledhës të vetëdeklarimit,sic kërkohet në pikën **2.3.3**, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Maj 2024**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Maj 2024**.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i *ndryshuar* dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i *ndryshuar*, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqerore (pushimet, leje e zakonshme),me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.Konkretnisht: Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve dhe me mjetet e këruara

për zbatimin me sukses të kësaj kontrate si dhe në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, sipas portalit SIM në e-albania si dhe në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimitari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar.

### **2.3.4 Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.**

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmoje se disponon licence profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme pér zbatimin e kontratës. Pér këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores pér kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojne veprimitari ndërtimi*”, i ndryshuar.

- **Pér punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:**

1. N.P. - 1 A (Punime gërmimi në tokë).
2. N.P. - 7 A (Ujesjelesa, gazsjelesa, vepra kullimi e vaditje).

- **Pér punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

1. N.S. - 18 A (Punime Topogeodezike)

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Pér prokurimin publik” i ndryshuar, nenin39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Pér miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “*Pér miratimin e rregullores pér kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale tëzbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojne veprimitari ndertimi*”, i ndryshuar. Stafi i inxhiniereve të licencuar bazohet në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 “Pér licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimitari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuar janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP - 1 A	Punime gjermimi në tokë	Zerat qe lidhen me germim dheu ne preventivat e punimeve	A
NP - 7 A	Ujesjelesa, gazsjelesa, vepra kullimi e vaditje	Ne perputhje me teresine e zerave te preventivit qe lidhet me skemen e kanalit te ujitjes	A
NS - 18 A	Punime Topogeodezike	Sipas zerave te preventivit dhe relacionit teknik	A

### **2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion:**

**a)** Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (*sipas formularit përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8*):

**“Reabilitim i Kanalit Ujitës "Vjosë- Levan- Fier": Dega e Martinës, (faza 3),**

NR.	EMËRTIMI I MAKINERISË DHE PAJISJES	SASIA	STATUSI
1	Betoniere 500 l	1	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njoitura nga legjislacioni në fuqi
2	Ekskavator 0.5 m3	1	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njoitura nga legjislacioni në fuqi

3	Tokmak Elektrik	1	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njoitura nga legjislacioni në fuqi
4	Autopompë betoni	1	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njoitura nga legjislacioni në fuqi
5	Autovinç me kapacitet ngritës min. 1 ton	1	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njoitura nga legjislacioni në fuqi
6	Autobetoniere	2	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njoitura nga legjislacioni në fuqi
7	Vibrator thellësie	1	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njoitura nga legjislacioni në fuqi
8	Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtës min 10 ton	2	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njoitura nga legjislacioni në fuqi

Shënim: Emërtimi i manovratorve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për preqatitjen teorike- praktike të kandidateve, si dhe dhenien e deshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë , si dhe disiplinimi i perdonimit te makinerive te ndertimit" kurse makinerit janeë nxjerr bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve", sipas portalit SIM në e-albania. Në pamundësi të instalimit të vinçit kullë në një ambjent të hapur siç është kanali është menduar që konkretisht zëri Vinç kullë 4-6 T me manovrator të zëvendësohet me autopompë betoni dhe Vinç kullë 0.5 - 1 ton me autovinç me kapacitet ngritës min. 1 ton.

**b)** Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qera), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte (*sipas formularit permblodhes te vetedekclarimit, sipas shtojcës nr.8:*)

- Kokore, minimumi 82 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.

- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 4 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 4 copë.

**Shënim:** Për pikën **2.3.5 (a dhe b)** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, në përfundim të fazës së dytë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit (për këtë fazë), duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.5 (a dhe b)**, duke dorezuar dokumentacionin original ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet **dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.**
- Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet **dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontraten perkatese noteriale të qerase ose ne një nga format e njohura nga legjislacioni ne fuqi, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.**
- Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me **Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme)**, leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën. Gjithashtu, kerkesat per disponimin ose mundësinë e sigurt te disponimit të

mjeteve apo kapaciteteve teknike te kerkuara ne kete kerkese per kualifikim, bazohet edhe ne nevojen per mundesine e sigurte te disponimit te mjeteve qe AK kerkon nga OE, te cilet duhet te vërtetojnë se zotërojnë kualifikime te nevojshme teknike, kapacitetet organizative, makineritë, pajisje te aseteve të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, duke demostruar kapacitet teknik si per mjetet qe do te angazhohen ne zbatimin e kontrates, ashtu edhe per kapacitet teknike qe lidhen me gadishmerine per plotesimin e tyre ne rrithana te caktuara, duke pasur si synim zbatimin e ne kohe dhe ne cilesi te kontrates objekt prokurimi. Përllogaritja e makinerive është bërë bazuar në - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve", sipas portalit SIM në e-albania.

**Kerkesat per makinerite/mjetet qe nevojiten argumentohet ne baze te zerave te preventivit:**

NR	EMËRTIMI I MAKINERIS Ë DHE PAJISJES	SASI A	MANOVRATOR /SHOFER	SHËNIME	Statusi
1	Betoniere 500 l	1	-	Zëri i preventivit me analizë 3.243/1	Në pronësi ose me qera ose ne një nga format e njoitura nga legjislacioni ne fuqi
2	Ekskavator 0.5 m3	1	Ekskavatorist	Zëri i preventivit me analizë 3.102/b, 3.161/1	Në pronësi ose me qera ose ne një nga format e njoitura nga legjislacioni ne fuqi
3	Tokmak Elektrik	1	-	Zëri i preventivit me analizë 3.47/1b	Në pronësi ose me qera ose ne një nga

					format e njojura nga legjislacion i ne fuqi
4	Autopomp betoni	1	Automakinist	Zëri i preventivit me analizë 2.262/1, 2.262/4	Në pronësi ose me qera ose ne nje nga format e njojura nga legjislacion i ne fuqi
5	Autovinc me kapacitet ngrites min 1 ton	1	Automakinist	Zëri i preventivit me analizë 3.287	Në pronësi ose me qera ose ne nje nga format e njojura nga legjislacion i ne fuqi
6	Autobetoniere	2	Automakinist	Zëri i preventivit me analizë 2.262/1, 2.262/4	Në pronësi ose me qera ose ne nje nga format e njojura nga legjislacion i ne fuqi
7	Vibrator thellësie	1	-	Zëri i preventivit me analizë 3.243/1	Në pronësi ose me qera ose ne nje nga format e njojura nga legjislacion i ne fuqi
8	Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtës min 10 ton	2	Shofer me leje drejtimi C	Zëri i preventivit me analizë 2.37/5b	Në pronësi ose me qera ose ne nje nga format e njojura nga legjislacion i ne fuqi

Shënim: Emërtimi i manovratorve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për preqatitjen teorike- praktike të kandidateve, si dhe dhenien e deshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë , si dhe disiplinimi i perdonimit te makinerive te ndertimit" kurse makinerit janë nxjerr bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve", sipas portalit SIM në e-albania. Në pamundësi të instalimit të vinçit kullë në një ambjent të hapur siç është kanali është menduar që konkretisht zëri Vinç kullë 4-6 T me manovrator të zëvendësohet me autopompë betoni dhe Vinç kullë 0.5 - 1 ton me autovinç me kapacitet ngritës min. 1 ton.

**2.3.6** Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyera ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent;

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Referuar natyrës së punimeve, përmasave te objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët të kryejnë punimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standartet e kërkua të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, menaxhimit të mjedisit, menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit per gjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përbushjen e plotë të kontratës.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" te ndryshuar.*

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë dërguar me shkresën me nr. 7099 prot., datë 02.07.2024 nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës, bashkëngjitur DST në SPE. Kriteret e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga specialisti i fushës pjesë e njësisë së prokurimit. Projektit i eshte bere oponanca teknike nga Instituti i Ndertimit me Nr.329/2 me date 18.04.2024. Sipas rekomandimeve te*

oponences eshte bere rishikimi dhe permiresimi i projekteve fillestare cituar kjo nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukture.

Përllogaritja e fuqisë punëtore dhe makinerive është bërë bazuar në - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve", sipas portalit SIM në e-albania.

Emërtimi i manovratorve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për prezentjen teorike- praktike të kandidateve, si dhe dhenien e deshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë , si dhe disiplinimi i perdorimit te makinerive te ndertimit". Në pamundësi të instalimit të vinçit kullë në një ambjentë të hapur siç është kanali u mendua që konkretisht zëri Vinç kullë 4-6 T me manovrator të zëvendësohet me autopompë betoni dhe Vinç kullë 0.5 - 1 ton me autovinç me kapacitet ngritës min. 1 ton.

Pikat e licencës së firmës/ave janë nxjerrë bazuar në VKM nr.42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimitari ndërtimi", i ndryshuar dhe preventivit të punimeve.

Stafi i inxhiniereve të licencuar bazohet në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimitari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" i ndryshuar.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjala "ose ekivalenti i tij/saj".*

### **Njësia e prokurimit:**